

  
**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETKES**  
*Drejtoria e Administrimit te Prones Publike*

**URDHER**

Nr. 435 Date 13.06.06

**PER BASHKIMIN E DY SHOQERIVE "NPV NR. 3" DURRES DHE  
"NPV NR. 4" DURRES  
NE NJË SHOQERITE VETME**

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe nenet 128, 254 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionerit të vetëm,

**URDHEROJ :**

1. Bashkimin e Sh.A. "NPV Nr. 3" Durrës dhe Sh.A. "NPV Nr.4" Durrës ne një shoqëri te vetme.
2. Ekspertja Kontabel e Autorizuar Zj. Flutra Lluka te pergatise raportin perkates ne përputhje me piken 1 te këtij urdhri.
3. Ngarkohen NPV Nr.3 Sh.A. dhe NPV NR.4 Sh.a .per zbatimin e ketij urdhri  
Ky Urdher hyn ne fuqi menjehere.

**MINISTER**

**GENC RULI**

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2  
E-mail: [smalko@mete.gov.al](mailto:smalko@mete.gov.al)  
Internet: <http://www.mete.gov.al>

Tel: +355 4 228467  
Tel: +355 4 223158  
Fax: +355 4 234052



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETKES**  
*Drejtoria e Administrimit te Prones Publike*

**URDHER**

Nr. 776 Date 01.11.96

**PER KRIJIMIN E SHOQERISE SH.A "NPV" DURRES DHE**  
**ÇRREGJISTRIMIN E SH.A. "NPV NR. 3" DURRËS DHE**  
**SH.A. "NPV NR.4" DURRËS**

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996 dhe nenet 128, 254 te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionerit të vetëm ,

**URDHEROJ :**

1. Krijimin e shoqërisë Sh.A. "NPV" Durres me kapital te nënshkruar 74,500,000 leke. i përbërë nga 74,500 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Te çregjistrohen shoqëritë Sh.A. "NPV Nr. 3" Durrës dhe Sh.A. "NPV Nr.4" Durrës.
3. Këshilli Mbikqyres i shoqërisë Sh.A. "NPV" Durrës përbehet nga:
  - Suzana Stefa
  - Jeta Abazi
  - Rajmonda Boksi
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Juridike per zbatimin e ketij urdhri.  
Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

Adresa: Blvd."Deshmoret e Kombit" Nr.2  
E-mail: [smalko@nmtc.gov.al](mailto:smalko@nmtc.gov.al)



## URDHEROJ

1. Krijimin e shoqerise sh.a NPV DURRES me kapital te nenshkruar 74. 500 .000 leke (shtatedhjeteekatermillion e peseqind mije leke ) I perbere nga 74 500 ( shtatedhjeteekatermije e peseqind) aksione , me vlere nominale 1000 leke sejcili.
2. Te c'rregjistrohen shoqerite SH.A. "NPV nr 3 " Durres dhe SH.A. "N.P.V. Nr 4.
3. Keshilli Mbikqyres I shoqerise sh.a . "NPV" Durres perbehet nga Suzana Stefa, Jeta Abazi dhe Rajmonda Boksi
4. Ngarkohen drejtoria e sherbimeve Juridike per zbatimin e ketij urdheri.  
Ky urdher hyn ne fuqi menjehere,

Ketyre urdherave I bashkangjitet , akti I vleresimit te kapitalit I kryer nga eksperti kontabel I autorizuar akti I themelimit , statuti I shoqerise Aksionere "N.P.V." Durres.

Prandaj mbeshitetur sa me lart une kerkuesi perfaqesues I shoqerise se re ne krijim e siper Drejtori I pergjithshem I emeruar nga keshilli mbikqyres Liliana Kola kerkoj ;

Te regjistrohet nje shoqeri e re qe vjen nga bashkimi I dy shoqerive anonime me te njeitin aksioner;

Shoqeria e re do te quhet "NPV" Durres dhe do te jete shoqeri anonime .

Aksioneri I vetem I shoqerise eshte shteti , qe perfaqesohet nepermjet Ministries se Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes dhe/ose titullarit te saj.

Kapitali themelor I nenshkruar eshte 74. 500 .000 leke (shtatedhjeteekatermillion e peseqind mije leke ) I perbere nga 74 500 ( shtatedhjeteekatermije e peseqind) aksione , me vlere nominale 1000 leke sejcili dhe zoterohet 100% nga aksioneri I vetem, shteti.

Keshilli mbikqyres I shoqerise SH.A. "NPV" Durres perbehet nga ;  
Suzana Stefa  
Jeta Abazi  
Rajmonda Boksi .

Objekti I veprimtarise se shoqerise do te perfshije ;  
Prodhim dhe tregtim konfeksione, import eksport.

Te c'rregjistrohen shoqerite aksionere "NPV nr 3 " sh.a dhe "NPV nr 4" sh.a.

Per sa nuk eshte shprehur ne aktin e themelimit dhe ne statut, I referohet legjislacionit ne fuqi.

Drejtores  
Liliana Kola

Liliana Kola



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANE**  
Nr. 15128 Akt.

**V E N D I M**  
**PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot me date 10-6-1996, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, 11 Deq. si shqyrtova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e shoqerise tregtare: "Prodhim Veshje Nr.4 Durres ne formen e nje shoqerie anonime :

**KONSTATOVA SE :**

Kerkuesi Ministria e Financave ka paraqitur kerkesen per t'u rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "Prodhim Veshje Nr.4" Durres me kohezgjatje pa afat te caktuar, me kapital themeltar 37.000.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke me objekt veprimtarie: Prodhim, tregtim konfeksione me material porositesi.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, Urdher Nr.149 date 13.05.1996 i Ministrise se Financave, kerkese per miratim eksperti jane te plote dhe te bazuar ne ligj dhe si te tille duhet te pranohen.

**PER KETO ARSYE :**

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare", si dhe nenit 33 ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te".

**V E N D O S A**

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Prodhim Veshje Nr.4" Durres me kohezgjatje pa afat te caktuar me kapital themeltar 37.000.000 leke me aksionist te vetem Ministrine e Financave, me vlere nominale te aksionit 1.000 leke dhe me objekt veprimtarie: Prodhim, tregtim konfeksione me material porositesi. Selia e shoqerise eshte ne Durres.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga :

1. Margarita Gjylameti
2. Nexhmije Prifti
3. Engjellushe Hysi

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte.

Tirane, me 10-6-1996

**GJYQTARE**

Margare. Prifti  
Engjellushe Hysi

## AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 8. 6. 1996, Ministria e Financave, ne baze te ligjit Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" Ministri i Financave, vendosi :

1. Te krijoj shoqerine anonime "Prodhim Veshje Nr.4"Durres.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: Prodhim tregtim konfeksione me material porositesi.

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres dhe ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.

4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 37.000.000 leke, nga kjo vlere e truallit 1.297.440 leke. Nr. i aksioneve 37.000.

5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

1. Margarita Gjylameti
2. Nexhmije Prifti
3. Engjellushe Hysi

7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

**DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE**

  
**BERZE PIRANIAN**